

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PROJEKTE & ZHVILLIM" SH.P.K

ME ADRESË

Njësia Administrative nr.5, Rruga "Medar Shtylla", Nd. 47, H. 23, Ap. 8
Kodi Postar 1019, Tiranë-Shqipëri

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë.

KREU 1

Sot, më datë 13/06/2022 (Trembëdhjetë Qershori Dy mijë e njëzetë e dy), themeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,

Anëtarë themelues:

Z. Raffaele Giampetrucci, atësia Daniele, i datëlindjes 21/07/1974, lindur e banues në Bari, shtetas Italian, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. e pasaportes YA8459310, vendosi të krijojë shoqerinë "PROJEKTE & ZHVILLIM" SH.P.K me këto kushte:

NENI 1

Emri i Shoqërisë.

Shoqëria është një entitet juridik privat.

Shoqëria do të prezantohet në marrëdhënie civile dhe juridike me emrin:

"PROJEKTE & ZHVILLIM" SH.P.K.

NENI 2

Objekti i Shoqërisë

Shërbime inxhinierike, ofrim të sherbimeve dhe performancës me përbajtje të lartë teknike dhe profesionale të tilla si studime fizibiliteti, hulumtime edhe të aplikuara, llogaritje dhe informatike, analiza dhe matje, konsultime, dizajn, drejtime operative, studime dhe vlerësimi ndikimi dhe kompatibiliteti mjedisor, mbikqyrje punimesh, koordinim të sigurisë në planifikim dhe në ekzekutim, në lidhje me sektorët e arkitekturës, planifikimit të peisazhit dhe atij urban, të territorit, monumental, dhe historik dhe të peisazhit, të inxhinierisë civile, industriale dhe të informacionit, në sektorin detar, aeronautik, hidraulik, atë të transportit, menaxhueshm elektrik, mekanik dhe impiantesh, mjedisit, tokës, infrastrukturës, energjisë, punëve publike, sigurisë dhe shëndetit në punë. Aktivitete profesionale për rikuperimin dhe ruajtjen e territorit. Studime gjeologjike, gjeoteknike, hidrogjeologjike, rilevime topografike, aerofotogrametrike, batimetrike, dhe të cdo tipi dhe lloji, me përdorimin e cdo lloji mjeti dhe instrumenti të disponueshëm. Kryerje aktivitetesh monitorimi fenomenesh të cdo lloji të ndërmarra edhe me ekzekutimin e rilevimeve, hetimeve, analizes, kampionimeve, inspektimeve, hulumtimeve, vleresimeve dhe karakterizimeve mjedisore, kimike, fizike ose të ndonjë natyre tjetër, kontolle dhe verifikime teknike shkatërruese dhe jo mbi pasuri të paluajtshme, impiante, makineri, sisteme dhe procese, kontolle për sigurinë dhe higjenën në vendin e punës, analiza të pasurive të patundshme në sektorin civil dhe industrial, publik dhe privat. Mbështetje për administratën publike dhe private, këshilla teknike dhe arministrative për prokurimin e punëve

Raffaele Giampetrucci
RG

publike, kryerjen e punëve, sigurinë dhe higjenën në punë, verifikimin e projekteve për vlerësimin dhe vlefshmérinë, vlerësimin e përputhjes tekniko-ekonomike.

Menaxhim të kontratave dhe monitorim të specifikimeve që lidhen me ofrimin e punimeve civile, industriale, detare, aeronautike, hidraulike, të infrastrukturës dhe transportit, mjedisore dhe/ apo territoriale, strukturore dhe mekanike. Konsulencë menaxhimi, organizim biznesi, marketing analistik, strategjik dhe operacional në fusha si: strategji, marketing, prodhim, logjistike, manaxhim projekt, cilësi, mjedis, siguri, siguri në vendin e e punës, sisteme informacioni dhe informatike, e-business, e-kommerce. Shërbime konsulence për zbatimin e sistemeve të cilësisë së mjedisit, sigurisë dhe përgjegjësisë social të sipërmarrjeve. Krijim dhe menaxhim të kurseve të mësimit dhe formimit, e-learning, formim dhe informim me ose pa qellim të drejtëpërdrejtë në formimin profesional. Shërbime dhe mbështetje të projekteve, shërbimeve dhe performancës me përbajtje të lartë teknike dhe profesionale në fushën inxhinierike, dhe që lidhen me fushën e ekzekutimit të arkitekturës, inxhinierisë civile, industriale dhe të informacionit, detare, të aeronautikes, hidraulike, manaxhuese, elektrike, inxhinieri mekanike dhe ngritje strukturash, të mjedisit, energjisë, automatizimit në shtëpi, sigurisë dhe shendetit në punë. Shërbimet për profesionistët, kompanitë dhe administratat publike dhe private, me pajisje, me ose pa operator për: përpunimin e të dhënavë, përpunimin grafik, shërbime telematike, matje të cdo lloji të madhësive fizike dhe kimike. Qiradhënie të ambjenteve të pajisura dhe makinave, makinerive, pajisjeve, mjeteve për matjet dhe analizën. Ndërtim të marrëdhënieve të agjencisë dhe pajisjeve tregtuese dhe sistemeve të teknologjisë së përparuar, instrumentalizim impiantesh në formën "me çelësa në dorë" në sektorët civile, industriale, dhe të informacionit, detar, aeronautik, hidraulik, të mjedisit, infrastrukturës dhe transporteve, mekanike, elektrike dhe të menaxhimit të territorit. Ofrim makinerish dhe shërbimesh për kontrollin e punës, mirëmbajtjen, sigurinë në punë, optimizimin e konsumit të energjisë, kontrollin e cilësisë të aktiviteteve civile, terciare dhe industriale. Furnizim me sisteme informatike hardeare dhe softolare dhe metoda monitorimi të territorit. Inxhinjerizim të proceseve industriale me ofrimin e sistemeve hardware dhe software.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Shoqëria do të zgjasë deri në 13/06/2032. Kjo kohëzgjatje mund të zgjatet një ose më shumë herë, pa cënuar të drejtë e shpërbërjes së parakohshme në bazë të një rezolute të Mbledhjes së Ortakëve.

NENI 4

Adresa e Shoqërisë

Shoqëria është e bazuar në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative nr.5, Rruga "Medar Shtylla", Nd. 47, H. 23, Ap. 8 Kodi Postar 1019, Tiranë-Shqipëri

KREU 11 KAPITALI

NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.000 ALL (njëmijë lekë)

Raffaella Giampetruzzi


Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: Z. Raffaele Giampetrucci është zoterues i 1 kuote (një kuote), që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali i shoqërisë do të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkon për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU 111

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

Organë Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

RAFFAELE GIAMPETRUZZI
RJ

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

Raffaele Giampetruzzi
RJ

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimitarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Administrator i shoqërisë “PROJEKTE & ZHVILLIM” SH.P.K do të jetë:

Znj. Edlira Tirana, banore e Republikës së Shqipërisë, lindur më 23/12/1979, madhore, e identifikuar përpara ligjit me numrin e kartës së identitetit numër personal H96223039M.

Administratori do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 1 vjeçare.

Nga data 01/06/2022 deri në 01/06/2023 dhe mund të rikonfirmohet në zyrë me një rezolutë specifike të Mbledhjes së Ortakëve.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmes rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Raffael Giampetruzzi
RG

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, irregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kryen veprimet e mëposhtme:


a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

RAFFAELLA GIAMPETRUZZI



d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti finanziar-ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Eksperti kontabël i shoqërisë do të jetë z. Elton Tirana, mbajtës i licensës nr. 257.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim, në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

RAFFAELE GIAMPETRIZZI


Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "PROJEKTE & ZHVILLIM" SH.P.K

RAFFAELLA GIAMPETRUZZI
RJL